



## ISO 22000

### Një *checklist* për standardin ISO 22000:2005

Sistemi i menaxhimit të sigurisë së ushqimit është përcaktuar si një veprimtari zinxhir ose si një set elementesh bashkëveprues, të cilët shërbejnë për vendosjen e politikave dhe objektivave, arritja e të cilave bëhet duke vendosur direkt në një organizatë/ kompani- sistemin e kontrollit lidhur me sigurinë e ushqimit.

Ky set elementësh bashkëveprues (*Checklist*) konsiston në pyetjet lidhur me aspekte të ndryshme të sistemit, implementimin dhe çertifikimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë së ushqimeve sipas standardit ISO 22000:2005, *Sistemet e menaxhimit të sigurisë së ushqimeve – Kërkesat për çdo lloj organizate/ kompanie të industrisë ushqimore*.

Ai i drejtohet të gjitha ndërmarrjeve të vogla e të mesme si në vendet e zhvilluara ashtu edhe në ato në zhvillim dhe jep një panoramë të përgjithshme të kërkesave të ISO 22000. Duke punuar me pyetjet e ndërtruara në mënyrën “hap pas hapi” i bën menaxherët e një ndërmarrjeje të aftë të vlerësojnë gjendjen aktuale të biznesit të tyre dhe i ndihmon ata të identifikojnë proceset kryesore për përmirësim. Kjo do të ishte një hap shumë i vlefshëm për kompaninë edhe pse çertifikimi i plotë i kompanisë mund të mos jetë i synuar.

*Checklist*-a është në 13 pjesë, ku secila nga ato mbulon një aspekt të caktuar të ISO 22000, dhe ku jepet një shpjegim i shkurtër i kërkesave përkatëse dhe udhëzuesi, i cili jep mënyrat se si të ndërpusë kërkesat në një sistem për menaxhimin e sigurisë ushqimore i destinuar për nevojat e çdo kompanie në veçanti. Për të qënë të suksesshëm nuk është e detyrueshme që të kompletohet çdo gjë menjëherë. Secila nga pyetjet e formuluarat kërkon përgjigje shkurt – PO ose JO. Kur përgjigja është PO konfirmohet që kompania e kupton për çfarë bëhet fjalë dhe se e ka përfshirë atë në sistemin e saj të menaxhimit të sigurisë ushqimore. Kur përgjigja është JO do të thotë që kompania nuk e ka të qartë se për çfarë bëhet fjalë dhe në këtë rast *Checklist*-a do t'i sigurojë kompanisë udhëzime dhe informacion shtesë.

ISO 22000 përmban kërkesa të ISO 9001:2000, *Sistemet e menaxhimit të cilësisë – Kërkesat*. Pjesa 14 e kësaj *Checklist*-e shpjegon ngjashmëritë midis këtyre dy standardeve. Nëse një organizatë/ kompani është çertifikuar sipas ISO 9001, do të thotë që në atë kompani është implementuar pjesa më e madhe e kërkesave të sistemit të menaxhimit të dhëna në ISO 22000:2005. Detyra e kësaj kompanie pastaj është të zhvillojë dhe të implementojë elementet e sigurisë ushqimore të dhëna në standardin e ri ISO 22000:2005.

### **Informacion i rëndësishëm:**

Për derisa *checklist*-a nuk përfshin tekstin e standardit ISO 22000:2005, të interesuarit mund të marrin një kopje të tij, në gjuhën shqipe, duke iu drejtuar Organit Kombëtar të Standardizimit në Shqipëri – Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit (DPS)

Rruga “Mine Peza”, Nr.143/3,

1014 - Tiranë, Shqipëri

Kutia Postare 98

Tel: (04) 22 62 55; (04) 24 71 75

Fax: (04) 24 71 77

E-mail: [info@dps.gov.al](mailto:info@dps.gov.al)

ose përmes website [www.dps.gov.al](http://www.dps.gov.al)